

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### **“PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 32/2018 “PËR FONDIN SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS””**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lindi nevoja për të bërë një analizë të kuadrit ligjor në fuqi për çështjet e diasporës. Për këtë qëllim është ngritur GP, i kryesuar nga ZVM që mbulon çështjet e diasporës, i cili ka analizuar gjithë kuadrin ligjor në fuqi për diasporën, duke mbajtur në konsideratë nga njëra anë politikën shtetërore dhe objektivat e MEPJ për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të popullsisë shqiptare që jeton jashtë kufijve të RSH-së, dhe nga ana tjetër nevojën për një centralizim të trajtimit të çështjeve të diasporës.

Në përfundim të kësaj analize propozohet rishikimi i këtij kuadrit ligjor, ku perfshihet edhe nevoja për shfuqizimin e ligjit nr. 32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” (FSHZHD).

Misioni i FSHZHD lidhet kryesisht me sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

Ky mision në kushtet e kalimit të çështjeve të diasporës në fushën e përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, duhet të realizohet nga kjo ministri që ka edhe tagrin ligjor për realizimin e tij.

Si rrjedhojë, duhet të përshtatet kuadri ligjor rregullator me politikat e zbatueshme si dhe shmangia e mbivendosjes të kompetencave dhe kostove të tepërta operacionale.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Hartimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2024.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i këtij projektligji pritet të krijojë lehtësi në qasjen koherente të politikave të angazhimit ndaj diasporës dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, mundësimi i një kanali komunikimi, në vend të atij me shumë drejtime, nëpërmjet centralizimit të çështjeve të diasporës. Përmbushja e objektivave të shtyllës “Ekonomia dhe Biznesi të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025”.

Gjithashtu synohet realizimi i objektivave të parashikuara në Kreun II, të vendimit nr.120, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe që lidhen me nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës nga një institucion qendror me struktura të posaçme që merren në përditshmërinë e tyre me çështjet e diasporës, si pjesë e detyrave funksionale.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, që prej vitit 2022 ka pasur mungesë fondesh, gjë që ka shkaktuar mosfunksionimin de facto të tij që para kalimit në fushë përgjegjësie të MEPJ-së. Si pasojë, ka humbur qëllimin e krijimit të FSHZHD-së, për sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

Mungesa e fondeve ka ardhur si rezultat i përfundimit të afatit të projekteve që subjekti ka realizuar, në kuadër të marrëveshjeve të lidhura nga Këshilli i Ministrave, si dhe projekte të financuara nga Këshilli i Ministrave, donatorë të ndryshëm, si dhe të ardhura nga aktivitete të veta (neni 7 i Ligjit nr.32/2018).

Pas një procesi rishikimi me qëllim përmirësimit në kuadër të llogaridhënies, efikasitetit dhe efektivitetit, lindi nevoja e ndryshimit në planin teknik dhe organizativ të kuadrit rregullator për çështjet e diasporës.

Së pari duhet të përshtatet kuadri ligjor rregullator me politikat e zbatueshme si dhe së dyti të shmanget mbivendosja të kompetencave dhe kostove të tepërta operacionale.

Përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në ligjin që propozojmë të shfuqizojmë të vijnë të realizohen nga vetë institucioni i MEPJ-së.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83 të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 2 dispozita. Neni 1, parashikon shfuqizimin e Ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, si dhe të gjitha aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si rezultat i një analize dalë nga Grupi i Punës i ngritur me urdhër nr.537/2023 të ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme, për rishikimin e kuadrit ligjor që rregullon çështjet e diasporës.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.